



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.436/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Acibadem Sistina Hospital”, e regjistruar në Maqedoni, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokate D.N. nga Prishtina, kundër debitorit “Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group” Sh.A. – Dega Kosovë, me seli në Prishtinë, rruga “Ukshin Hoti” nr.13, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.354/18 të datës 16.05.2018 të Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 18.08.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group” Sh.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.354/18 të datës 16.05.2018 të Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr.354/18 i datës 16.05.2018 i Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.354/18 të datës 16.05.2018, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Fatura Nr.2912922936 e datës 14.02.2017, Nr.2912928800 e datës 28.02.2017, Nr.2912940931 e datës 28.03.2017, Nr.2912940934 e datës 28.03.2017; ku e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj borxhin kreditorit në shumën prej 55,206.00 € në bazë të dokumentit të besueshëm me kamatë ligjore, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit prapësim përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur debitori me të cilin e ka kontestuar urdhrin për përmbarim me arsyetimin se faturat janë fiktive e cila vërtetohet edhe mungesa e nënshkrimit të debitorit. Andaj i propozon Gjykatës urdhrin përmbarimor ta anuloj si joligjor dhe ta hedh poshtë.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara për arsye se urdhri përmbarimor është lëshuar në bazë të dokumenteve të besueshme të cilat përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme. Tutje thekson se me asnjë prove debitori nuk e ka provuar faktin se faturat janë anuluar, ndryshuar apo kanë humbur efektin juridik. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës ta refuzoj prapësimin si të pabazuar dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata në ri procedurë duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit sipas vendimit AC.nr.4664/2018 të datës 04.01.2019, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pa bazuar, andaj, të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilit: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me të cilën do të mund të argumentonte pretendimet e cekura në prapësim apo se ekziston ndonjëri nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të

njëjtit nen, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar*“, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata konstaton se në këtë çështje përmbardimore urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në faturat e lartcekura të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, ngase në to janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat/shërbimet të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave dhe shuma e cila është detyrim për përmbardje nga ana e debitorit.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila vërtetohet nga garancioni i pagesës me numër reference 17-02-00 T si dhe komunikimi me postë elektronike i datës 27.03.2017 ku pranohet borxhi nga ana e debitorit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbardimore, vlerëson se urdhri për përmbardim i lejuar mbi bazën e dokumenteve të besueshme nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit lidhur marrjen e shërbimeve mjekësore nga ana e të siguruarës së debitorit, erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e shërbimeve mjekësore dhe vlerësimin e ekspertizave mjekësore, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbardimi, si dhe

përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, bazuar në nenin 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.436/22, datë 18.08.2023

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate